

**QYTETI I SHKUPIT
SEKTORI PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL
SHKUP**

**SHTOJCA E APLIKIMIT
PËR NDARJEN E MJETEVE PËR FINANCIMIN E MANIFESTIMIT:
"DITA E FILIGRANIT"**

**PËRMBAJTJET DHE KRITERET QË DUHET TË PËRMBUSHEN NGA REALIZUESI I
MANIFESTIMIT: "DITA E FILIGRANIT"**

1. PËRMBAJTJA E MANIFESTIMIT

Manifestimi pritet të jetë një destinacion për prezantimin e traditës maqedonase në punimin e filigranit si një traditë shekullore dhe një thesar i krijimtarisë kulturore dhe artistike. Pritet të jetë një nxitje për brezat e rinj me qëllim afirmimin dhe promovimin e pasurisë materiale dhe jo materiale të Shkupit në një mënyrë me qasje të dalluar:

- Pritet që të ftohen shoqatat vendase, oda e punës dhe artizanët nga industria krijuese për të prezantuar vlerat kulturore dhe tradicionale të historisë dhe traditës sonë me qëllim promovimin e Qytetit të Shkupit;
- Pritet të ofrohet një listë bashkëpunimi dhe ftesa për pjesëmarrje për sipërmarrësit e vegjël ose kompanitë startup që mund të promovojnë produktet tradicionale maqedonase me simbolikën e Qytetit përmes filigranit të punuar me dorë;
- Të ofrohet një projekt i shkurtër për zhvillimin e manifestimit të kushtuar prodhimit të filigranit;
- Të sigurohen stenda përfaqësuese për prezantimin dhe promovimin e filigranit të punuar me dorë;
- Të organizohet ceremoni e hapjes së ngjarjes nga Kryetari i Qytetit të Shkupit;
- Ftesa për prezantuesit e tjerë të punimeve artizanale (artizanë nga argjendi, ari, bakri, gurët e çmuar, teli, perlat, etj.) sipas zgjedhjes së realizuesit të Projektit dhe sigurimi i shitjes së tyre;
- Shënimi, përcaktimi i hapësirës së dedikuar për ditën/ditët e filigranit dhe, pas ngjarjes, kthimi i saj në gjendjen e saj para përdorimit.

2. KUSHTET PËR REALIZIMIN E MANIFESTIMIT

- Përvojë në organizimin dhe koordinimin e manifestimeve, evenimenteve dhe festivaleve që përfshijnë zejtarët dhe artizanët, të paktën pesë vjet;
- Koha e mbajtjes - në konsultim me Qytetin e Shkupit;
- Vendndodhja: Vendndodhje tërheqëse në konsultim me Qytetin e Shkupit;
- Infrastruktura: në marrëveshje me Qytetin e Shkupit;
 - shënimi i zonës ku do të zhvillohet manifestimi ku do të vendoset logoja e Qytetit të Shkupit në vend të dukshëm,
 - sigurimin dhe lidhjen e instalimeve elektrike,
 - sigurimin e zërit dhe ndriçimit të përshtatshëm sipas vendndodhjes dhe ambienteve,
 - stendat prezantuese të shitjes, kabinat, banakët, tavolinat dhe stolat për vizitorët,
 - sigurimin e animacionit aktiv të përshtatshëm të evenimentit sipas programit të evenimentit (skicë e shkurtër e një projekti me ide),
 - posedimin e pajisjeve të përshtatshme për logjistikën e manifestimit,
 - sigurimin e pajisjeve të përshtatshme muzikore për përmbushjen e programit muzikor ose skenës së evenimentit (kontratë ose para kontratë me një kompani për pajisjet e duhura),
 - Prodhimin e materialeve promovuese në të cilat logoja e Qytetit të Shkupit do të vendoset në vend të dukshëm.
- Informimi i Shërbimeve të Sigurisë në lidhje me ngjarjen (në marrëveshje me Qytetin e Shkupit dhe Ministrinë e Brendshme);
- Angazhimi i një agjencie për të ruajtur rendin publik në lokalitetin e qytetit;
- Mbulimi mediatik i manifestimit, si nga mediet elektronike ashtu edhe nga ato të shkruara (një javë para ngjarjes, konferencë për shtyp për të informuar publikun, paraqitje e të ftuarve në një emision, informacion që do të ndahet në mediat sociale, stacionet radiofonike, gazetatat elektronike);
- Sigurimi i një drafti - propozimi grafik të përshtatshëm për materialin promovues të ngjarjes (poster, fletushkë, broshurë, pllaketë, fletë falënderimi);
- Mbajtja e një regjistri të veçantë të dokumenteve mbi të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me organizimin e manifestimit, i cili do t'i dorëzohet qytetit pas përfundimit të ngjarjes.

3. KRITERET PËR LIDHJEN E KONTRATËS PAS THIRRJES PUBLIKE

Për bartës të Kontratës në lidhje me Thirrjen publike do të zgjidhet ai aplikim që do të vlerësohet si më i favorshëm nga totali i pikëve për secilin element në veçanti.

Kritere	Maksimum pikët
1. Struktura organizative dhe resurset	30
1.1 Aplikanti ka strukturën e nevojshme organizative dhe burimet njerëzore për realizimin e manifestimit (punonjës, vullnetarë aktivë, individë të angazhuar me kontratë, etj).	10
1.2 Aplikanti disponon me logjistikë (hapësirë zyre dhe pajisje teknike për realizimin e manifestimit).	10
1.3 Dukshmëria e aplikantit në internet	10
2. Financimi i propozim projektit për realizimin e manifestimit	30
2.1 Plani financiar i detajuar për mjetet e nevojshme për realizimin e manifestimit.	10
2.2 Aplikanti siguron një përqindje të pjesëmarrjes së tij në realizimin e projektit.	10
2.3 Plan financiar real (përshkrimi i shpenzimeve sipas pozicioneve të kategorive përkon me çmimet e tregut).	10
3. Kualiteti i propozim projektit për realizimin e manifestimit	40
3.1 Qëllimi i përgjithshëm i qartë dhe i përcaktuar i propozim projektit, i cili do të sjellë realizimin e prioriteteve të dhëna. Nga Programi për aktivitete nga fusha e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit	10
3.2 Zgjidhje cilësore dhe inovative të ofruara në projektin e propozuar.	10
3.3 Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave të tjera.	10
4 Projekti i propozuar për realizimin e manifestimit është i qartë dhe i realizueshëm.	10

*Çdo fushë e kriterëve të veçanta do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, me kuptimin e mëposhtëm: 1 - jo, 5 - pjesërisht, dhe 10 - po.

*Shënim:

- Në propozimin e projektit të paraqitur, duhet të dorëzohet listë e artizanëve, zejtarëve dhe artistëve krijues që punojnë në artizanat dhe që do të marrin pjesë në manifestimin;
- Të dorëzohet një pëlqim i nënshkruar për shfaqjen e interesit për pjesëmarrje në manifestimin, për çdo shoqatë, dhomë, sipërmarrës, kompani fillestare;
- Duhet të deklarohet përvoja e aplikantit në organizimin e manifestimeve që lidhen me artizanët dhe zejtarët (gjatë vlerësimit do të merret parasysh organizimi i manifestimeve të një lloji të ngjashëm për sa i përket masovitetit së manifestimit, kohëzgjatjes, etj.);
- Në propozimin e projektit të paraqitur, nëse ekziston duhet të dorëzohet programi i argëtimit (emra muzikorë, instrumentistë, interpretues, etj.).
- Duhet të dorëzohen biografitë e organizatorëve të manifestimit.

Përpilues, Rukije Asani
Kontrolloi, Marina Misajlleski
Lejoi, Marina Misajlleski

KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT
Orce Gjorgjievski
